

PASQYRA E LENDES


Pasqyra e lendes.....	faqe 1
Kapitulli 1 - Hyrje.....	faqe 2
Kapitulli 2 - Planimetria e sheshit.....	faqe 4
Kapitulli 3 - Heqja e vijes projektit.....	faqe 5
Kapitulli 4 - Infrastruktura.....	faqe 6
4.1 Rrjeti kanalizimeve te ujrave te zeza.....	faqe 6
4.2 Rrjetet e kanalizimeve te bardha.....	faqe 7
4.3 Rrjeti ujesjellesit.....	faqe 8
4.4 Rrjeti elektrik.....	faqe 8
4.5 Rrjeti ndricimit rrugor.....	faqe 8
4.6 Rrjeti telekomunikacionit.....	faqe 9
4.7 Sinjalistika rrugore.....	faqe 10
4.8 Gjelberimi, rampat e invalideve dhe kontenieret	faqe 10
Kapitulli 5- Llogaritja e shtresave dhe nenshtresave. Grafiku AASHTO.....	faqe 10
Kapitulli 6- Preventivi	
Kapitulli 7- Grafiku	
Kapitulli 8- Tabela e materialeve	



SHESHI

1) HYRJE

-Sheshi MINATORI ne Memaliaj eshte nje shesh me rruge te demtuara dhe me lulishte me nje pamje te demtuar dhe arkaike ka nje siperfaqe te pergjitheshme qe do te rikonstruktohet prej 10056 m2. Sheshi ndodhet ne verilindje te qytetit te Memaliajt

Fotografi te sheshit "MINATORI"







Kjo shesh eshte ripunuar per here te fundit ne vitet 1980 e jane shume te demtuara nga nderhyrjet ne rrjete e ndryshme inxhinierike si kanalizime ujesjelles e tjere nga firmat dhe banoret e ndryshem. Per pasoje gjendja e rrugeve te sheshit eshte e rende dhe amortizuara ne pjese te ndryshme te saj.

Persa i perket rrjeteve ekzistuese te infrastruktures rrugore ku bejne pjese rrjeti Kanalizimeve te ujrave te zeza ,ujrave te bardha, rrjeti elektrik ,rrjeti telekominikacionit, rrjeti telefonik si edhe sinjalistika rrugore

jane si me poshte. Rrjeti i kanalizimeve do te behet i ri pasi egzistuesi eshte me diameter te vogel dhe nuk e perballon prurjen pasi ne te derdhen dhe ujrat e shiut. Ne rrjetin e ujesjellesit nuk nderhyhet pasi jane ne gjendje te mire. Do te behen te reja kanalizimet e ujrave te bardha , rrjeti i telekomunikacionit IT, rrjeti i tubacioneve dhe pusetave te rrjetit te mesem elektrik me perspektive futjen e ketij rrjeti nen toke si dhe rrjeti i ndricimit dhe rrjeti i tensionit mesem. Studimi i bere parashikon qe keto rrjete te rehabilitohen duke iu pershtatur kerkesave te kohes dhe nevojave te relatuara nga ndermarrjet perkatese.

2) PLANIMETRIT E SHESHIT

Sheshi "Minatori" rrethohet nga tre rruge nga te cilat rruga ne jugperendim eshte dhe mbetet me dy korsi me gjeresi 6.0 ML. Rruga ne veriperendim eshte dhe mbetet me dy korsi me gjeresi 8.4 ML me dy korsi dhe me parkim ne te dy anet e rruges. Rruga ne verilindje eshte dhe mbetet me nje korsi me gjeresi 4.0 ML

Ne te dy anet e rrugeve ndertohen bankina me gjeresi 40 cm. Ne rruges vendosen bordura 20x30 cm me gure te punuar ne siperfaqe. Ne te gjithë rrugët qe rikonstruktohen do te behet ndricim i ri. Eshte parashikuar mbjellja me peme dekorative.




2) HEQJA E VIJES PROJEKTIT

Ne terheqjen e vijes se projektit per te gjitha rruget eshte pasur parasysh vija egzistuese e projektit duke bere disa korigjime te vogla sepse ato kuota lidhen me hyrjen ne banesa dhe objekte tregtare.







4) INFRASTRUKTURA RRUGORE

Ne kete seksion zberthehet i gjithe aspekti i infrastruktures se rruges. Shpjegohen gjendjet ekzistuese per cdo rrjet dhe jepen perspektiva nga cdo ndermarrje per ti dhene zgjidhje te vlefshme infrastrukturore duke rritur keshtu funksionalitetin dhe paprekshmerine e rruges ne te ardhmen.

4.1 Rrjetet e kanalizimeve te ujrave te zeza

Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza do te behet i ri ne te3 akst e rrugeve A,B,C dhe 1. Lidhja e ujrave te zeza do te behet tek puseta ne hyrje te sheshit ne aksin deri ku vjen rrjeti i ri i kanalizimit. Kanalizimet behem me **tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm.**

4.2 Rrjetet e kanalizimeve te ujrave te bardha

Rrjeti kanalizimeve te ujrave te bardha do te behet i ri pasi nga vrojtimi ne vend eshte i amortizuar Tubot e shkarkimit te ujrave te bardhe **tub I brinjezuar HDPE Ø 150 mm.**

4.4 Rrjeti Elektrik

Nga ana jone eshte parashikuar ne te dy akset kryesore te rrugeve linja nentoksore e tensionit mesem TM.Linjat nentoksore jane bere me tub plastik O 100 mm dhe pusetat jane lene ne cdo kryqezim rruge.

4.5 Rrjeti i ndricimit rrugor

Ne zonen qe rikonstruktohet ka nje ndricim te dobet .. Kjo linje do te ribehet e gjitha.Ne te dyja anet e rrugeve vendosen ndricues dekorative te vendosur ne shtylla dekorative me dy dege.Ndricohen gjithashtu dhe shatervanet si dhe te dy monumentet me prozhektore.

4.6 Rrjeti i vaditjes e shatervaneve

Ne shesh do te kete lulishte dhe tre grupe shatervanesh. Per kete arsye per te mos perdorur ujin e pijshem eshte parashikuar te ndertohet nje pus per vaditje dhe furnizimin e shatervaneve. Uje i shatervaneve eshte me riqarkullim.

4.7 Sinjalistika rrugore

Ne zonen qe rikonstruktohet dhe ne rrugen e re nuk egziston asnje lloj sinjalistike keshtu qe ajo do te behet e re qe nga tabelat e deri tek vijezimet.

4.8 Gjelberimi, rampat e invalideve

Ne gjendjen aktuale gjelberimi i rruges egziston ne te dy krahet. Ne te dy anet e rrugeve do te mbillen peme te reja por pemet e vjetra qe nuk bien tek monumentet dhe tek shatervanet do te ruhen. Per kete arsye nevojitet te behet nje studim i mirefillte ne menyre qe zona te pajiset me peme. Gjithashtu ne cdo nderprerje te trotuareve ku kemi kryqezime do te ndertohen rampa me pjerrresi te ulet ne ndihme te invalideve. Ne pozicione te vecanta te studiuara .

4) LLOGARITJA E SHTRESAVE DHE E NENSHTRESAVE

Koncepti i rruges se re ndryshe nga e vjetra konsiston ne skarifikimin e rruges egzistuese nga ku do te hiqet shtresa e asfaltit , binderit dhe stabilizantit. Shtresat e rruges do te behen me 10 cm stabilizant 7 cm binder dhe 5 cm asfaltobeton elementet e te ciles dalin nga llogaritjet e marra nga literatura (MODELLO DI CATALOGO DELLE PAVIMENTAZIONI STRADALI) si dhe nga KTP-89 . Nga kushtet konstruktive duhet qe te permiresohen ndjeshem cilesite fiziko-mekanike te tabanit te tokes. Kjo arrihet duke ndertuar shtresa zhavorrike me fraksione te ndryshme, te ngjeshura mire dhe te lara. Trashesia e ketyre shtresave vendoset ne baze te kushteve konstruktive KTP-89. Ne figuren 2 eshte paraqitur skematikisht stratifikimi i ri per segmentin tone. Perpara fillimit te llogaritjeve duhet qe te disponojme disa te dhena paraprake si te dhenat mbi trafikun, tonazhi i lejuar, karkteristikat fiziko mekanike te tabanit te tokes ku mbeshteten shtresat tona.

SHTRESAT RRUGORE

Dimensionimi i shtresave dhe verifikimi i tyre eshte bazuar ne

MODELLO DI CATALOGO DELLE PAVIMENTAZIONI STRADALI

L. Domenichini, P. Di Mascio
P. Giannattasio, C. Caliendo, B. Festa
A. Marchionna, P. Finni, E. Molinaro, G. Paoloni

Karakteristikat paraprake baze jane:

Trafiku ne jetegjatesine 15-20 vjecare te rruges

Ulja elastike e lejuar 0.51 mm

Automjeti njesi eshte automjeti me ngarkese ne aksin e mbrapem 81.6 kN ngarkese boshtore.

Shtresat e reja me beton dimensionohen ne baze te teorise se elasticitetit me deformim elastik te lejuar nen roten e automobilit qe dimensionohet.

Te dhena te tjera baze per projektimin e shtresave rrugore jane:

1. Ngarkesa e trafikut me akse standart per jetegjatesine 20 vjecare te veperes:
 $W_{18} = 3 \text{ deri } 5 \times 10^6 \text{ ESAL}$ (mjete njesi standart 81.6 kN per aks)

2. Besueshmeria: **95%**
3. Devijimi i pergjithshem standart $S_0=0.44$
4. Moduli resilent i tabaneve (duke marre parasysh rastet me te disfavorshme $Mr=35 \text{ Mpa}$)
5. Humbja e sherbimit te projektimit $\Delta PSI=2$

Trafiku konsiderohet "i rende deri i mesem": $3-5 \times 10^6$ AADT ne jetegjatesine 15-20 vjecare te rruges;

Trafiku llogarites, duke patur parasysh se kemi te bejme me nje rruge te re, i koospondon nje trafiku 1 000 deri 2 000 aut njesi/24 ore, percaktuar ne "Raportin Teknik te Studimit te Trafikut te Rruges" (v.2005). Ne dimensionimin e shtresave rrugore merren ne konsiderate materialet rethanore si dhe kushte te tjera gjeologjike, hidrologjike dhe klimatike.

Kompozimi i metejshem i shtresave rrugore (bashkelidhur jane paraqitur llogaritjet) mendohet te jete:

Themeli dhe nenthemeli i rrugeve lidhese qe jane pa asfalt do te jene ;

Keto jane projektuar me kete perberje:

a) ne mbushje:

- 30 cm (2x15 cm) zhavor lumi $> 31.5 \text{ mm}$ ($E=350-450 \text{ Mpa}$)
- 20 cm (2x10cm) cakell $< 31.5 \text{ mm}$ ($E=350-450 \text{ Mpa}$)

b) shtresa e perdorimit:

Paketa e perdorimit Paketa e perdorimit, ka kete perberje:

- ⇒ 7 cm binder
- ⇒ 6 cm asfaltobeton
- ⇒ 10 cm stabilizant

Gjithsej paketa e perdorimit eshte parashikuar 13 cm shtresa asfaltike dhe 10 cm stabilizant, gje qe garanton jetegjatesine dhe fortesine e tyre per nje trafik te cilesuar "te rende deri te mesme" te rruges se ardhshme Me ne detaje shtresat e rruges tregohen ne llogaritjet dhe vizatimet e punes se profilave terthor tip qe shoqerojne kete raport teknik.

SHENIM : Para fillimit te punimeve firma fituese e tenderi duhet te konsultohet me ndermarrjet Ujesjelles Kanalizime , OSSH , Albatelekomit per thellesine e vendosjes se linjave perkatese dhe pozicionin e tyre pavarisht projektit azhornues te dhene nga to .

Linjat e telekomunikacionit jane aktualisht te vendosura 30 ~ 40 cm nen toke dhe linjat e objekteve te tjera deri ne 70 cm nen toke.

Ne rast te demtimit te linjave te mesiperme nga firma zbatuese pergjegjesia do te bjare mbi firmen.

RIKONSTRUKSIONI FASADAVE

-Objektet qe ndodhen ne kufijte e sheshit "MINATORI" jane objekte te vjetra dhe me fasada te demtuara dhe me nderhyrje te banoreve ne fasada duke prishur dhe pamjen e tyre. Ne juglindje te sheshit ndodhet pallati kultures, ne veriperendim te sheshit ndodhen 1 ndertese 5 kateshe ,dhe ne anen veri lindore ndodhen nje ndertese 4 kateshe 3 ndertesa 3 kateshe 1 ndertese 2 kateshe e 2 ndertesa 1 kateshe.

Objekti 5 kat ne anen verilindore



Objektet ne anen veriperendimore



Objektet 3 kate ne jugperendimore



Objektet ne anen veriperendimore**2) KONSTRUKSIONI**

Shtesat e godinave qe do te ndertohen behen me konstrukcion b/a C20/25. Objektet jane llogaritur me themele te vazhduar b/a dhe kollona qe jane te dimensioneve 20x50cm ,50x20/50x30cm.



Soleta eshte monolite me $h=15$ cm qe mbeshtetn mbi trare 25x40 cm.



Traret terthor te soleteve mbeshteten mbi kollona dhe ne anentjeter ne ndertesat egzistuese.

Ne llogaritje jane marre parasysh ndemjet e lejuara te tokes $R_{llog.}=1.8$ kg/cm².

Sizmiciteti eshte marre 8 balle te shkalles Rihter.

Objektet jane llogaritur me programin Psistem(Stereostatika). Ne fotot poshte tregohen skemat e llogaritjes se dy nenobjekteve 2 e 3.





a. MATERIALET

- ▶ Klasa e betonit te parashikuar ne projekt per pllaken e themelit eshte C25/30.
 - ▶ Klasa e betonit te parashikuar ne projekt per elementet vertikale, kolonat dhe strukturat horizontale, trare dhe soleta eshte C25/30
 - ▶ Celiku i perdorur ne objekt eshte importi S 500 me kufi rrjedhshmerie $\sigma_{rrj} = 500$ MPa. Kjo klase hekuri eshte parashikuar per te gjitha llojet e armaturave te perdorura ne objekt.
- Rezistencat llogaritese (te projektimit) per betonin dhe celikun jane marre nga reduktimi i rezistencave karakteristike sipas klases se betonit (apo celikut) te perdorur me faktorin e sigurise perkates si me poshte:

Per celikun:

$$f_{yd} = f_{yk} / \gamma_s$$

$$f_{ywd} = f_{ywk} / \gamma_s$$

Per betonin:

$$f_{cd} = f_{ck} / \gamma_c$$

$$f_{cwd} = f_{cwk} / \gamma_c$$

Materialet e perdorura paraqiten ne menyre tabelare si me poshte :

MATERIALS			
Column Concrete Type:	C25/30	Column Stirrup Steel Type:	S500
Slab Concrete Type:	C25/30	Column Bar Steel Type:	S500:
Beam Concrete Type:	C25/30	Slab Bar Steel Type:	S500:
Shear Walls Concrete Type:	C25/30	Shear Bar Steel Type:	S500:
Rough Foundation Concrete Type:	C20/30	Beam Bar Steel Type:	S500:
Inactive Walls Concrete Type:	C25/30	Foundation Bar Steel Type:	S500:
Slab Stirrup Steel Type (Zoellner Slabs):	S500	Beam Stirrup Steel Type:	S500

b. ANALIZA DHE LLOGARITJA KOMPJUTERIKE

Analiza statike dhe dinamike per te percaktuar reagimin e struktures ndaj tipeve te ndryshme te ngarkimit te struktures eshte kryer me programin **StereoSTATIKA V 3.53** Modelimi i struktures ne teresi dhe i cdo elementi behet mbi bazen e metodikes se elementeve te fundem (Finite Element Metode- FEM) e cila eshte nje metode e perafert dhe praktike duke gjetur

perdorim te gjere sot ne kushtet e epersise qe krijon perdorimi i programeve kompjuterike.

Analiza dinamike ka ne bazen e saj analizen modale me **metoden e spektrit te reagimit**. Ngarkesat dinamike, (sizmike) te llogaritura pranohen si ngarkesa ekuivalente statike dhe ushtrohen ne vendin e masave te perqendruara. Si baze per metoden e llogaritjeve dinamike me metoden e spektrit te reagimit sherben **analiza e vlerave te veta dhe e vektoreve te vete**. Me ane te kesaj metode percaktohen format e lekundjeve vetjake dhe frekuencat e lekundjeve te lira. **Vlerat dhe vektoret e vete** japin pa dyshim nje pasqyre te qarte dhe te plote per percaktimin e sjelljes se struktures nen veprimin e ngarkesave dinamike. Programi **StereoSTATIKA** automatikisht kerkon modet me frekuenca rrethore me te uleta (perioda me te larta) –*shiko piken 8*- si me kontribuese ne thithjen e ngarkesave sizmike nga struktura. Numri maksimal i modeve te kerkuara nga programi eshte kushtezuar nga vete konstruktori ne $n=9$ mode, nderkohe qe masat e kateve te ketij objekti jane konsideruar me tre shkalle lirie, ne te cilat 2 rrotulluese dhe nje translative sipas planit te vete soletes. Frekuenca ciklike f (cikle/sec), frekuenca rrethore ω (rad/sec) dhe perioda T (sec) jane lidhur midis tyre nepermjet relacioneve: $T=1/f$ dhe $f=\omega/2\pi$. Si rezultat i analizes merren zhvendosjet, forcat e brendshme (M, Q, N,) dhe sforcimet σ ne cdo emelente te struktures. Analiza me metoden e spektrit te reagimit eshte kryer duke perdorur superpozimin modal. (Sipas Wilson & Button 1982).

c. NGARKESAT LLOGARITASE NE PROJEKT

c.1 Ngarkesat e perhershme (Dead Loads-DL)

Ne ngarkesat e perhershme jane perfshire: Pesha vetjake e gjithe elementeve mbajtes te struktures beton arme (themele, trare, kolona, pesha vetjake e soletave, shtresave te dyshemese, muret ndares vetembajtes me tulla me bira, dhe parapetet e ballkoneve, shkalleve etj). Ngarkesat e normuara qe jane marre ne considerate per strukturen e mesiperme jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

DEAD LOADS					
Concrete specific gravity:	25.00	kN/m ³	Slab coating:	1.50	kN/m ²
Steel specific weight:	78.00	kN/m ³	Room tiling:	1.50	kN/m ²
Header wall weight:	3.60	kN/m ²	Staircase tiling:	1.30	kN/m ²
Stretcher wall weight:	2.10	kN/m ²	Soil specific gravity:	18.00	kN/m ³

c.2 Ngarkesat e perkohshme (Live Loads-LL)

Si ngarkesa te perkohshme ne structure jane llogaritur ngarkesat e shfrytezimit te dyshemeve te dyqaneve, nderkateve te banimit, shkalleve, ballkoneve, taracave etj, te cilat ne menyre te permbledhur jane paraqitur gjithashtu ne tabelen e meposhtme :

LIVE LOADS					
Residences floors:	2.00	kN/m ²	Offices floors:	2.00	kN/m ²
Balconies floors:	5.00	kN/m ²	Staircases floors for residences:	3.00	kN/m ²
Stores floors:	4.00	kN/m ²	Staircases floors for stores:	3.00	kN/m ²

Ngarkesat e mesiperme jane nominale dhe ne varesi te kombinimit per te cilin do te kontrollohet struktura, ngarkesat e perhershme (DL) apo ato te perkohshme (LL) shumezohen me koeficientin

perkates te sigurise.

c.3 Ngarkesat sizmike: (**Earthquake Loads-EL**)

Ne perputhje me studimin inxhiniero-sizmiologjik te sheshit, parametrat e marre ne llogaritje jane :

Shpejtimi i truallit (PGA)	$a_g = 0.24 \text{ g}$ (8 Balle, Kategoria e 2-te)
Kategoria e Truallit	`` E Dyte ``
Koeficienti i sjelljes se struktures	$q=3.0$
Koeficienti i rendesise	$k_r=1.0$
Koeficienti i shuarjes	$\zeta=5\%$
Faktori i korrjigimit te shuarjes	$\eta=1$
Faktori i themeleve	$\beta=2.5$
Objekt i rregullt ne lartesi	$K_r=1$

SEISMIC PARAMETERS			
Earthquake Risk Zone: (PGA)	0.24	Building Importance Factor:	1.00
Seismic Behaviour Factor (q):	3.00	Foundation Factor:	1.00
Spectral period (T1):	0.10	Spectral Amplification Factor:	2.50
Spectral Period (T2):	0.40	Critical Damping Factor:	0.05
Spectral Exponent:	0.67		

d. KOMBINIMI I NGARKESAVE

Percaktimi i aftesise mbajtese te struktures (ULS) eshte kryer duke kombinuar ngarkesat vepruese ne struktures sipas kombinimeve te meposhtme:

A	$1.35G + 1.50Q$	1C	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy - 0.30Ey+eccx$
1B	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy + 0.30Ey+eccx$	1E	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy + 1.00Ey+eccx$
1D	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy + 1.00Ey+eccx$	1G	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy + 0.30Ey+eccx$
1F	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy - 0.30Ey+eccx$	1I	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy - 1.00Ey+eccx$
1H	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy - 1.00Ey+eccx$	2C	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy - 0.30Ey+eccx$
2B	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy + 0.30Ey+eccx$	2E	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy + 1.00Ey+eccx$
2D	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy + 1.00Ey+eccx$	2G	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy + 0.30Ey+eccx$
2F	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy - 0.30Ey+eccx$	2I	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy - 1.00Ey+eccx$
2H	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy - 1.00Ey+eccx$	3C	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy - 0.30Ey-eccx$
3B	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy + 0.30Ey-eccx$	3E	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy + 1.00Ey-eccx$
3D	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy + 1.00Ey-eccx$	3G	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy + 0.30Ey-eccx$
3F	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy - 0.30Ey-eccx$	3I	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy - 1.00Ey-eccx$
3H	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy - 1.00Ey-eccx$	4C	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy - 0.30Ey-eccx$
4B	$1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy + 0.30Ey-eccx$	4E	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy + 1.00Ey-eccx$
4D	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy + 1.00Ey-eccx$	4G	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy + 0.30Ey-eccx$
4F	$1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy - 0.30Ey-eccx$	4I	$1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy - 1.00Ey-eccx$
4H	$1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy - 1.00Ey-eccx$		

Elementet e struktures jane kontrolluar edhe ne perputhje me deformimet e lejueshme qe shkaktohen ne to nga veprimi i ngarkesave normative. Ne keto kombinime koeficientet e kombinimit te ngarkesave jane pranuar njesi.

Efekt i perdredhjes aksidentale eshte perfshire ne llogaritjen e godines duke u inkorporuar automatikisht ne nivelin e forcave sizmike. Jashtequndersia e veprimit te forcave sizmike per cdo kat eshte pranuar 5 % e dimensionit te godines perpendikular ne drejtimin sizmik ne studim.

Ne perputhje me kategorizimin e bere ne EC8, godina e projektuar eshte e klasit II, per te cilen faktori i rendesise eshte $\gamma_f=1.0$. (Sipas KTP-N2- 89, godine e klasit te III-te me $\gamma_r= 1.00$.)

d. REZULTATET

Mbi bazen e rezultateve te dimensionimit te elementeve eshte bere edhe armimi i tyre si dhe detajimi i sejcilit element ne vecanti.

Me poshte jane paraqitur ne menyre te detajuar nje pjese e llogaritjeve kompjuterike, te cilat perfshijne llogaritjen e soletave, trareve dhe kolonave te disa kateve te objektit.

f. Rrjeti elektrik i ndricimit

Ne rrjetin e kollonateve qe shtohen ne ripunimn e fasadave do te vendosen ndricime. Ndricimi behet tavanor duke u vendosur nga nje ndricues ne mes te katroreve te krijua midis kater kollnave nga 2 ne cdo krah si ne projekt.

Ndricim i fasadave merret dhe nga ndricimi i rrugeve dhe i lulishteve.

*Prof.
F. Sh. ...
Arhitekt*



pen
Procurement
Albania

MOSTRAT E GURIT

SHESHI “RILINDJA” MEMALIAJ

Guri i bucarduar me ngjyre te bardhe me nuance bezhe dhe gri, do te perdoret per realizimin e forumit qytetar.



Nje variant i perdorimit te gurit pa bucardim.



Shenim: Permasat e gurit do te percaktohen nga arkitektet projektues, pasi te jene realizuar mostrat ne objekt.

Ky lloj guri do te perdoret edhe per shtrimin e zones pedonale me kete ngjyre.

PROJECT & PEOPLE

ARBENGOLEMI



MOSTRAT E GURIT SHESHI “RILINDJA” MEMALIAJ

Guri ngjyre gri si me poshte do te perdoret ne zonen pedonale per realizimin e konfiguracioneve.



Po me kete lloj guri do te realizohen edhe te gjitha bordurat e gurit, me konfiguracionin e meposhtem. Permasat do te percaktohen pasi te shihen mostrat nga arkitektet.



PROJECT & PEOPLE

ARBENGOLEMI

